

VENDIM

Nr. 314, datë 31.5.2018

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NR. 3 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT
NR. TF013972, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/SHOQATËS
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA DHURUES TË NDRYSHËM, NËN FONDIN
E DYTË TË BESIMIT SHUMËDHURUES PËR SHQIPËRINË, PËR MBËSHTETJEN
PËR NGRITJEN
E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN
E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT
TË INTEGRUAR (SPI) 2**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit nr. 3 të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) 2, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**BANKA BOTËRORE
BNRZH - IDA | GRUPI I BANKËS BOTËRORE**

22 dhjetor 2017

Shkëlqesisë së Tij Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Lënda: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve shqiptare për zbatimin e Sistemit të
Planifikimit të Integruar (IPS)2 - Granti nr. TF013972 amendamenti nr. 3 i
Marrëveshjes së Grantit**

Shkëlqesi:

Ne i referohemi Marrëveshjes së Grantit të datës 7 mars 2013 (Marrëveshja) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Banka Botërore), të ndryshuar, për Fondin e Mirëbesimit me Shumë Donatorë *për mbështetje*

për ngritjen e kapaciteteve shqiptare për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) 2 (Projekti) dhe letrës suaj me nr. prot. 9612/3, datë 8 gusht 2017, me anë të së cilës i kërkon Bankës Botërore të shtyjë Datën e Mbylljes për Grantin, të përmendur më sipër sipas Marrëveshjes.

Në lidhje me sa më sipër dhe diskutimet tona më të fundit, Banka Botërore propozon të amendojë Marrëveshjen si vijon:

1. Seksioni 3.03 i Marrëveshjes amendohet dhe zëvendësohet tërësisht dhe do të lexohet si vijon:

“3.03. **Periudha e tërheqjes.** Data e mbylljes, e referuar në seksionin 3.06(c) të kushteve standarde është 30 qershor 2019.”

2. Seksioni 4.01 i shtojcës së Marrëveshjes amendohet dhe zëvendësohet tërësisht dhe do të lexohet si vijon:

“4.01 **Përfaqësuesi i Marrësit.** Përfaqësuesi i Marrësit, i referuar në seksionin 7.02 të kushteve standarde është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.”

3. Seksioni 4.02 i shtojcës së Marrëveshjes amendohet dhe zëvendësohet tërësisht dhe do të lexohet si vijon:

“4.02 **Adresa e Marrësit.** Adresa e Marrësit, e referuar në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.
Republika e Shqipërisë
Faksimile: + 355 4 222 8405”

Të gjitha afatet dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, me përjashtim sa është amenduar këtu, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni pranimin tuaj në lidhje me amendimin e mësipërm, duke e nënshkruar dhe vendosur datën në këtë letër, në hapësirën e dhënë më poshtë. Kjo letëramendimi do të realizohet në dy kopje të njëjta, ku secila prej tyre do të jetë origjinale dhe njëra prej tyre do të kthehet te ne. Dispozitat e vendosura në këtë letëramendimi do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit nga Marrësi për Bankën Botërore në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Nga *(nënshkrim)*

Maryam Salim

Menaxhere e vendit

Zyra e Bankës Botërore, Tiranë

Republika e Shqipërisë

PRANUAR:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____
Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____